

SKEDË INFORMUESE

Thirrjen e hapur për projekte për bashkitë “Rights of the child and children’s participation” (CERV-2025-CHILD) nën Programin CERV

Programi Citizens, Equality, Rights and Values (CERV) është një program financimi i Bashkimit Evropian që synon të promovojë të drejtat themelore, demokracinë, barazinë dhe vlerat në vendet anëtare. Ky program mbështet financiarisht me grante projektet që luftojnë diskriminimin, promovojnë barazinë gjinore, mbrojnë të drejtat e njeriut dhe forcojnë pjesëmarrjen demokratike. Përmes tij, synohet ndërtimi i një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe respektimi i vlerave të përbashkëta evropiane. Programi CERV është i ndarë në 4 komponentë: “Citizens”, “Equality”, “Rights” dhe “Union Values”. Shqipëria është pjesë e programit CERV vetëm në komponentët "Citizens", "Equality" dhe "Rights".

Synimi i thirrjes:

Thirrja CERV-2025-CHILD synon të mbështesë politikat gjithëpërfshirëse për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e fëmijëve, duke përfshirë të drejtën për pjesëmarrje dhe adresimin e nevojave dhe sfidave aktuale të fëmijëve në BE.

Kjo thirrje fokusohet në zbatimin e veprimeve dhe rekomandimeve në BE, në nivel kombëtar dhe lokal të Strategjisë së BE-së për të drejtat e fëmijës. Ajo synon t'u përgjigjet nevojave dhe sfidave aktuale të fëmijëve në BE. Projektet mund të jenë kombëtare ose ndërkombëtare. Këto të fundit inkurajohen veçanërisht.

Prioritetet e thirrjes:

- Të drejtat e fëmijëve në epokën dixhitale.
- Angazhimi dhe pjesëmarrja e fëmijëve.
- Integrimi i perspektivës së të drejtave të fëmijëve në veprimet në nivel kombëtar dhe lokal.

Rezultatet e pritshme:

- Fëmijët do të jenë më të vetëdijshëm për të drejtat e tyre dhe më të aftësuar për t'i ushtruar ato.
- Do të përmirësohet shëndeti mendor dhe mirëqenia e fëmijëve në sferën dixhitale.
- Mekanizmat e pjesëmarrjes së fëmijëve do të jenë gjithëpërfshirës dhe sistematikë.
- Do të përmirësohen kapacitetet e autoriteteve publike për të mbështetur të drejtat e fëmijëve.

Kush mund të aplikojë dhe çfarë konsorciumi pranohet:

- Aplikuesit duhet të jenë entitete ligjore (publike ose private) ose organizata ndërkombëtare.
- Konsorciumet duhet të përbëhen nga të paktën **dy aplikantë**. Për prioritetin 3, përfshirja e **një autoriteti publik** është e detyrueshme.

Aktivitetet të pranueshme:

- Zhvillimi i mjeteve arsimore për sigurinë online dhe aftësitë dixhitale.
- Trajnime dhe materiale për profesionistët dhe fëmijët mbi pjesëmarrjen demokratike.
- Zhvillimi i mekanizmave të qëndrueshëm të pjesëmarrjes së fëmijëve në politikë-bërje.
- Etj, në varësi të prioritetit të zgjedhur.

Cili është buxheti i thirrjes dhe si është ndarë në prioritete:

Buxheti i përgjithshëm i thirrjes është **17,000,000 EUR**, ku:

- **9,000,000 EUR** për prioritetin "Të drejtat e fëmijëve në epokën dixhitale."
- **5,000,000 EUR** për prioritetin "Angazhimi dhe pjesëmarrja e fëmijëve."
- **3,000,000 EUR** për prioritetin "Integrimi i të drejtave të fëmijëve."

Kohëzgjatja e projekteve normalisht duhet të jetë nga 12 deri në 24 muaj. Zgjatjet e kohëzgjatjes janë të mundshme, nëse justifikohen siç duhet.

Buxheti për secilin projekt-propozim:

- Shuma minimale e grantit: **200,000 EUR**.
- Shuma maksimale e grantit: Pa limit (po jo më shumë se sa është caktuar për prioritetin e zgjedhur).

Si bëhet aplikimi:

- Aplikimet dorëzohen përmes Portalit të Financimit dhe Tenderëve të BE-së.
- Dokumentet e kërkuara përfshijnë:
 - Formulari i aplikimit Part A (bëhet online);
 - Formulari i aplikimit Part B (bëhet me dokument që plotësohet dhe pastaj ngarkohet online në sistem);
 - KPI (bëhet online);
 - Buxheti i detajuar (bëhet me dokument që plotësohet dhe pastaj ngarkohet online në sistem);
 - CV-të (sipas standardit Evropian) të ekipit kryesor të projektit;
 - Raporti i aktivitetit të vitit të kaluar të koordinatorit (përveç nëse është organ publik);
 - Letër mbështetëse nga autoriteti publik (për prioritetin 1 dhe 2). Për prioritetin 3, meqenëse ai u drejtohet drejtpërdrejt autoriteteve publike, përfshirja e tyre në konsorcium është e detyrueshme qoftë si kryesues ose si bashkë-aplikues;

- Për cilindo nga pjesëmarrësit që zbatojnë aktivitete që përfshijnë fëmijë (nën moshën 18 vjeç):
 - subjektet private, duhet të dërgojnë një dokument mbi politikën e tyre të mbrojtjes së fëmijëve (CPP) që mbulon katër fushat e përshkruara në Standardet për Mbrojtjen e Fëmijëve të Sigurt të Fëmijëve.
 - Njësitë publike duhet të bëjnë të paktën një deklaratë nderi.

Kur është afati i fundit:

- Hapja e thirrjes: **16 Janar 2025**.
- Afati i fundit: **29 Prill 2025**, ora 17:00 (ora e Brukselit).

Nëse keni nevojë për më shumë informacion ose ndihmë shtesë mbi këtë thirrje, na njoftoni!